POP 5
Lajmet me të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Pas lëvizjes brenda PD, Salianji si fytyrë Nokia-Dumbhaqi, shkëmtimove partiake! Debate ‘ditë ashpra edhe me Berishën. Stanuli nuk mti ndërsa takimet me demokratët
2 Vanessa Hudgens, nënë për herë të parë
3 Rep-pop/ Kërgëllësit, modernizmi dhe sëmuri, artistë shqiptarë që i bëjnë ti gjithë
4 34 prona milionia euro dhe dyemdi taksonte, Josefina Trypali: Po pengojnë me frikë per bukën e gojës
5 ‘Na të mbajnë’ ry me mqkursi 120 mijë euro! Bëtërn Ahmetaj ta thotë ne ry Rockin. Salianji na ka ardhur me shkop bejtoshi, por mënduh njerëzi

Kronikë

U ndalua në Greqi si vrasës me pagesë, policia kontroll në banesën e 45-vjeçarit në Gjirokastër

Gjatë kontrolleve në banesat e disa shtetasve shqiptarë të dyshuar si vrasës me pagesë në Gjirokastër, Vlorë dhe Lezhë, u sekuestruan 3 armë zjarri automatike, 200 fishekë kallashnikovi, 18 pako me fishekë pistolete dhe 5 krehra.

Armët e sekuestruara nga policia

Sh.com Redaksia
11 Dhjetor, 18:59 | Përditësimi: 11 Dhjetor, 19:23

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjirokastër-Policia e Shtetit ka ushtruar kontroll në banesën e Dhimitër Meçit në Gjirokastër, i cili u ndalua dy ditë më parë në Greqi si vrasës me pagesë. Policia finalizoi operacionin policor të koduar "Provat", në bashkëpunim me Policinë Greke, duke zbuluar dhe sekuestruar një arsenali armësh zjarri dhe municioni luftarak.

Gjatë kontrolleve në banesat e disa personave shqiptarë të dyshuar si vrasës me pagesë në Gjirokastër, Vlorë dhe Lezhë, u sekuestruan 3 armë zjarri automatike, 200 fishekë kallashnikovi, 18 pako me fishekë pistolete dhe 5 krehra.

Një pjesë e armëve dhe municionit u gjetën në banesën e shtetasit 45-vjeçar Dhimitër Meçi, i ndaluar më parë në Greqi.

LEXO EDHE:
'Vetëm fëmijët të shpëtojnë' klithma e nënës në Katundisht të Këlcyrës: Jemi pa ilaçe e ushqime! Shtëpia po shembet

Njoftimi i Policisë së Shtetit:

> *'Finalizohet operacioni policor i koduar "Provat". Bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe Policisë Greke çoi në zbulimin dhe sekuestrimin të një arsenali armësh zjarri dhe municioni luftarak.*
>
> *Sekuestrohen 3 armë zjarri automatike, 200 fishekë kallashnikovi, 18 pako me fishekë pistolete dhe 5 krehra. Armët dhe municioni luftarak u gjetën në një nga banesat e një prej të arrestuarve në Greqi, të dyshuar si vrasës me pagesë.*
>
> *Në kuadër të bashkëpunimit mes Policisë shqiptare dhe Policisë greke, pas shkëmbimit të informacionit për kapjen e disa shtetasve shqiptarë në Greqi, të dyshuar si vrasës me pagesë, strukturat e Policisë së Shtetit në Gjirokastër, Vlorë dhe Lezhë, në kuadër të operacionit policor të koduar "Provat", zhvilluan kontrolle në banesat e këtyre shtetasve.*
>
> *Si rezultat i kontrollit në fshatin Labovë e Kryqit, shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër gjetën të fshehura, në banesën e shtetasit Dh. M., 45 vjeç, 2 kallashnikovë dhe një armë zjarri automatike, të dyshuar të trafikuar dhe qindra fishekë të kalibrave të ndryshëm.*
>
> *Armët e zjarrit, që u gjetën në banesën e 45-vjeçarit, i ndaluar 2 ditë më parë në Greqi, mbi akuza për vrasje dhe pjesëmarrje në grup kriminal që posedonte armë zjarri, do të dërgohen tek Instituti i Policisë Shkencore për ekspertim teknik.*
>
> *Me qëllim dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të shtetasve shqiptarë Dh. M., 45 vjeç, banues në Labovën e Kryqit Gjirokastër; A. B., 32 vjeç, banues në Kudhës Himarë; F. P., 39 vjeç, banues në Lezhë; dhe P. Th., 31 vjeç, banues në Muzinë Sarandë, të dyshuar si vrasës me pagesë, strukturat e Departamentit të Policisë Kriminale, ato të DVP Gjirokastër, Vlorë e Lezhë, në bashkëpunim me Prokurorinë, po vijojnë hetimet e thelluara duke koordinuar dhe bashkëpunuar ngushtësisht me homologët grekë.*
>
> *Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".*

Në prangat e policisë greke **më 9 dhjetor** ranë Dhimitër Meci, 45 vjeç, Andrea Brokeri, Fatjon Prendi, ndërsa në kërkim është shpallur Petro Theohari. Ata dyshohet se janë autorë të ngjarjes së ndodhur në Athinë më 16 maj 2025, kur ndaj automjetit të blinduar të 41-vjecarit grek Jani Lala, u qëllua rreth 50 herë me automatik, por pa mundur ta vrasin e as ta plagosin. Personi që ka shkrepur këmbëzën, dyshohet të jetë Dhimitër Meci, një person i akuzuar për disja vrasje me pagesë në Greqi.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: Fatjon Prendi | andrea brokeri | dhimiter meci | Petro Theohari | Gjirokaster

Komentoj

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 11 Dhjetor, 07:30
Çfarë vlerësimi keni për drejtimin e SPAK nga Altin Dumani?
Anoj pozitiv | Anoj negativ | Të përzier

Lajme të tjera

Gjirokastra festive/ Muzika e Emio Morricones jehon në qytetin e gurtë me interpretimin e artistëve italianë
Piro Nase
13 Dhjetor, 15:52

Gjirokastër/ Dyshime për fshehje të të ardhurave, ndalohen 4 persona, sekuestrohen vlera në lekë, euro, paund dhe dollarë amerikanë
12 Dhjetor, 16:39

Fermerët grekë vijojnë të bllokojnë rrugët kombëtare! Aksi Kakavijë-Janinë, i pakalueshëm nga ora 18:00-21:00
12 Dhjetor, 13:22

Foltorja 'shkon' në Gjirokastër, salla plot! Salianji: PD gaboi edhe me Avokatin e Popullit, firmosi për kandidaturat që donte Rama! Pse nuk mbështetën njerëzit tanë?
11 Dhjetor, 21:42

Gjirokastër/ Jepnin me fajde para të përfituara nga krimi, 3 në pranga, 1 tjetër në kërkim! Sekuestrohen 26.9 milionë lekë, mijëra euro, dollarë e franga
11 Dhjetor, 16:25

Protestat e fermerëve grekë bllokojnë sërish aksin Kakavijë-Janinë, i pakalueshëm nga ora 13:00-16:00! Do të lejohen vetëm për automjetet e emergjencës
11 Dhjetor, 10:04

Muzeu i Armëve në gjendje skandaloze, uji i shiut bie mbi objektet historike! Bashkia e Gjirokastrës, 10 vite pa kryer asnjë investim
Piro Nase
6 Dhjetor, 16:06

Shqipëria vend tranzit për kalimin e emigrantëve të paligjshëm, do ngrihen 20 qendra pritje në Vlorë, Gjirokastër e Korçë
Raziela Myslimaj
5 Dhjetor, 13:57

Tentoi të kalonte përmes doganës së Kakavijës 22 mijë euro pa i deklaruar, nis hetimi për 54-vjeçarin
4 Dhjetor, 10:31

Greqia e 'paralizuar', fermerët vijojnë të bllokojnë rrugët kombëtare! Aksi Kakavijë-Janinë i pakalueshëm nga ora 18:00-21:00
4 Dhjetor, 10:11

Greqia e 'paralizuar', fermerët vijojnë të bllokojnë rrugët kombëtare! Aksi Kakavijë-Janinë i pakalueshëm duke filluar nga ora 19:00
3 Dhjetor, 11:43

Greqia e 'paralizuar', fermerët vijojnë të bllokojnë rrugët kombëtare! Aksi Kakavijë-Janinë i pakalueshëm deri në 20:00
2 Dhjetor, 08:51

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje